

INVESTITOR:

Rrahman A. Agushi B.I

IMPIANTI FOTOVOLTAIK 6.0 MW – SOJEVË dhe MIROSALË, FERIZAJ



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR IMPIANTIN FOTOVOLTAIK ME KAPACITET 6.0 MW
SOJEVË DHE MIROSALË, KOMUNA FERIZAJ**

**VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS PËR IMPIATIN FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET 6.0 MW (6.5 ha) – PARCELA ME NR. 02054-0, ZONA
KADASTRALE SOJEVË DHE PARCELA ME NR. 02083-9, ZONA KADASTRALE
MIROSALË, KOMUNA FERIZAJ**

APLIKUESI:

HARTUESIT E RAPORTIT TË VNM-SË

Rrahman A. Agushi B.I
Sojevë dhe Mirosalë, Ferizaj

Blerina BAJRAKTARI, Bsc. Hidro.
Prishtinë

+383 44 506 486

Blerinabajraktari3@gmail.com

+383 49 588 634

Rrahmani A. Agushi B.I



Ferizaj, Nentorë 2024

Përmbajtja:

1.	HYRJE	6
1.1	Qëllimi i Raportit të VNM-së	6
2.	BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT	8
3.	METODOLOGJIA E HARTIMIT TË RAPORTIT	8
3.1	Zona e studimit	9
3.2	Te dhënat dhe analiza studimore.....	12
4.	PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM	12
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	15
5.1	Flora dhe Fauna	15
5.2	Klima	16
5.3	Temperatura	16
5.4	Lagështia relative e ajrit	17
5.5	Vrantësimi dhe diellosja	17
5.6	Të reshurat	17
5.7	Era.....	18
5.8	Shtypja atmosferike	18
5.9	Cilësia e ajërit	18
5.10	Djellosja.....	19
5.11	Karakteristikat Hidrografike.....	20
5.12	Gjeologjia dhe Pedologjia	22
5.13	Lartësia Mbidetare	25
5.14	Pylltaria.....	25
5.15	Popullsia	27
5.16	Ndikimet mjedisore te lidhura me popullatën dhe shëndetin	28
6.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE PROCESIT TEKNOLOGJIK.....	29
6.1	Parimi i punës së qelizave fotovoltaike	32
6.2	Invertorët	33
6.3	Intensiteti i rrezatimit diellor	34
6.4	Mirembajtja	37
6.5	Struktura e Vendosijes se Paneleve Fotovoltaike	37
6.6	Linja e transmetimit dhe pika e lidhjes.....	38
7.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS	38
7.1	Ndikimi Në Mjedis	38
7.2	Ndikimi në tokë gjate ë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit.....	40
7.3	Ndikimet në ujë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit.....	41
7.4	Ndikimi në nivelet e zhurmës gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit.....	42
7.5	Ndikimi në pejzazh gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit	42
7.6	Ndikimi në florë dhe faunë gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe Demolimit	43
7.7	Ndikimi social.....	45

7.8	Rreziku i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.....	46
7.9	Ndikimet në trashëgiminë kulturore	46
7.10	Ndikimet Kumulative	46
7.11	Mbeturinat dhe masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit	47
8.	MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN E DHE ZVOGLIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS	50
8.1	Masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe dekomisionimit/ çmontimit për mbrojtjen e ajrit.....	50
8.2	Masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit për mbrojtjen e tokës	50
8.3	Masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit për mbrojtjen e ujëra ve	50
8.4	Masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit për mbrojtjen nga zhurma.....	51
8.5	Masat e marrura gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit për mbrojtjen e peizazhit	51
8.6	Masat e marrura për mbrojtjen e florës dhe faunës gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe demolimit	51
9.	PËRSHTATSHMËRIA DHE ARSYESHMËRIA E PROJEKTIT DHE LOKACIONIT	52
10.	PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT MJEDISOR	55
11.	DEBATI PUBLIK DHE KONSULTIMET E PALËVE TË INTERESUARA.....	61
12.	PLANI I DEMOLIMIT DHE RIKULTIVIMIT	61
13.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	62
14.	LITERATURA E PERDORUR	64
15.	KOSTO INVESTIVE E PROJEKTIT	63

Lista e Figurave:

Figura 1	Procesi i prodhimit të energjisë diellore me anë të paneleve fotovoltaike	6
Figura 2.	Parcelat në të cilat do të vendosen panelet solare.....	10
Figura 3.	Lokacioni me objekte për rreth në zonën kadastrale Mirosalë.....	10
Figura 4.	Lokacioni me objekte për rreth në zonën kadastrale Sojevë	11
Figura 5.	Largësia me qytetin e Ferizajit	11
Figura 6	Shtirja hapësinore e lokacionit të Impiantit Fotovoltaik 6.6 MW – Sojevë dhe Mirosalë	12
Figura 7	Plani i situacionit me dhe pa ortofoto në përpjesë të lexueshme me të gjitha të dhënat e nevojshme siç kërkohet në Ligjin për VNM	13
Figura 8	Largësia e zonës së projektit nga zonat e mbrojtura dhe Lumi me i afërt.....	14
Figura 9	Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën 1949 – 2007	16
Figura 10	Mesatarja vjetore e diellosjes viti 2018	17
Figura 11	Reshjet Mesatare Vjetore.....	18
Figura 12	Harta e fuqisë potenciale të rrezatimit fotovoltaik në territorin e Kosovës.....	20

Figura 13 Rrjeti Hidrografik i Komunës së Ferizajt	22
Figura 14 Harta gjeologjike e Komunës së Ferizajt.....	24
Figura 15 Harta Pedologjike e Komunës së Ferizajt	24
Figura 16 Impianti Fotovoltaik paraqitja skematike	29
Figura 17 Pv Modulet e planifikuara për vendosje në parkun solar 6.0 MW	30
Figura 18.Parimi i Punës së qelizave ne Fotovoltaike	32
Figura 19. Një sistem PV i lidhur në rrjet	34
Figura 20 Rrezatimi diellor i lokacionit të Hulumtuar.....	35
Figura 21.Këndi i rrezeve te diellit dhe këndi i Azimutit dhe zenitit.....	35
Figura 22.Azimuti Solar per Lokacionin e Hulumtuar	36
Figura 23 Mirëmbajtja e paneleve model se si duhet te jete.....	37
Figura 24 Struktura e Vendosjes së Paneleve Fotovoltaike	37
Figura 25. Harta gjeologjike e lokacionit të projektit	39
Figura 26 Harta e rrezatimit diellor ne lokacionin e Hulumtuar.....	54

Lista e Tabelave:

Tabela 1 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën1949 – 2007	16
Tabela 2 Pjerrtësia e terrenit sipas përqindjes dhe sipërfaqes në hektarë	25
Tabela 3 Karakteristikat e vendbanimeve të Komunës	28
Tabela 4 Plani i Menagjimit dhe Monitorimit Mjedisor	56

1. HYRJE

Sistemi Solar Fotovoltaik shndërron energjinë e dritës së Diellit në Energji Elektrike. Ky shndërrim kryhet pa konsumuar lëndë Djegëse fosile. Përdorimi i një burimi të sigurt të energjisë siç është Dielli e bënë këtë teknologji lehtë të aplikueshme. Përparësitë kryesore të një sistemi solar fotovoltaik janë: Prodhimi i shpërndarë i energjisë, nuk ka emetim të materialeve ndotëse, kursimi i lëndës djegëse dhe jetëgjatësia si pasojë e punës në qetësi të pajisjeve përbërëse. Intensiteti i prodhimit të energjisë varet drejtpërdrejtë nga ndryshueshmëria e pozitës së diellit gjatë ditës dhe vitit. Energjia diellore prodhohet nga një sistem fotovoltaik i ndryshëm, ndër ta: këndi i rrezes së diellit në vendin ku planifikohet instalimi i sistemit, orientimi dhe këndi i vendosjes së moduleve fotovoltaike, prezenca ose jo e hijeve, performanca teknike e pjesëve përbërëse të sistemit.




Figura 1 Procesi i prodhimit të energjisë diellore me anë të paneleve fotovoltaike

1.1 Qëllimi i Raportit të VNM-së

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është hartuar me qëllim për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet deri në 6.6 MW në Lokacionin e fshatit Sojevë dhe Mirosalë, përkatësisht në parcelën me nr. P – 72217058-02083-9 dhe P-72217082-02057-0, Komuna Ferizaj.

Duke u bazuar në kërkesat që dalin nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ku për ndërtimin e Impiantit fotovoltaik së pari duhet hartuar raportin e VNM-së për tu pajisur me Pëlqim Mjedisorë dhe pastaj marrjen e lejeve dhe licencave tjera të cilat kërkohen sipas legjislacionit vendor.

Duke u Bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, kompania “**Rrahman A. Agushi B.I** ka angazhuar personat e licencuar për hartimin e këtyre raporteve të cilët janë të nënshkruar në fillim të këtij Raporti.

Për të përmbushur kushtet të cilat dalin nga Ligji i VNM-së Raporti duhet të përfshij:

- Studimi se si do të funksionoj projekti duke u bazuar në kuadrin ligjor mjedisor dhe Direktivave Evropiane.
- Për hartimin e raportit të VNM-së duhet të merren parasysh të dhënat nga terreni në lidhje me shfrytëzimin e tokës, përfitimet socio ekonomike dhe ekologjike. Po ashtu duhet hulumtuar të dhënat tjera në lidhje me hidrometeorologjinë, shfrytëzimi dhe cilësia e tokës, gjeologjia, gjeomorfologjia, hidrologjia ekologjia dhe socio ekonomia në vendin e planifikuar për ndërtimin e Impiantit fotovoltaik.
- Identifikimi, parashikimi dhe vlerësimi i aspekteve dhe ndikimeve të mundshme me ndjeshmëri të ndryshme mjedisore për shkak të aktiviteteve të projektit të parashikuara gjatë fazave të ndërtimit, funksionimit dhe demolimit;
- Të verifikohet gjendja mjedisore afër lokacionit të projektit se a ka specie të rrezikuara apo të mbrojtura.
- Rekomandimi i masave me të përshtatshme dhe përmirësuese për ndikimet mjedisore,
- Krahasimi dhe analiza e alternativave të konsideruara për projektin në lidhje me vendndodhjen dhe teknologjinë e prodhimit të energjisë,
- Plani i menaxhimit dhe monitorimit Mjedisor.




Figure 1 Impianti fotovoltaik solar 6MW

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është i rregulluar me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08 / L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të Raportit të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08 / L-181 ka për qëllim të siguroj një vlerësim të përgjithshëm të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen, me qëllim që të parandalohen dhe të zvogëlohen apo mënjanohen efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Gjatë hartimit të këtij Raporti janë marrë në konsideratë edhe Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për rregullimin e bazës së kompanisë dhe zhvillimit të veprimtarisë së kompanisë **“Rrahman A.Agushi B.I** , që janë si më poshtë:

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin e lartpërmendur janë si më poshtë:

- ✚ Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03 / L-025;
- ✚ Ligji për VNM Nr. 08 / L-181;
- ✚ Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04 / L-174;
- ✚ Ligji nr. 08/L-071 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina;
- ✚ Ligji për Ndërtimin Nr. 04 / L-110;
- ✚ Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03 / L-233;
- ✚ Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02 / L-102;
- ✚ Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- ✚ Ligji për Energjinë Nr. 05/L-081
- ✚ Ligji për rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084
- ✚ Ligji për Energji Elektrike Nr. 05/ L-085
- ✚ Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110;
- ✚ Ligji për Kimikatet Nr. 04 / L-197;
- ✚ Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04 / L-147;
- ✚ Ligji Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes Nr .03 / L-043;
- ✚ Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08 / L-025;

Dhe aktet e nënligjore përkatëse për zhvillimin e projektit.

3. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË RAPORTIT

Hartimi i Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis është bazuar në legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar, përveç eksperiencës profesionale dhe konsultimeve që janë bërë me ekspertët që do të udhëheqin procesin, për ndërtimin e Impiantit fotovoltaik në Sojevë dhe Mirosalë me kapacitet prej 6.0 MW (e cila do të ndërtohet në 6.5 ha të parcelave me nr. 02057-0 në Zonën Kadastrale Sojevë që ka gjithësej 55986 m² dhe parcela me nr.02083-9 në Zonën Kadastrale Mirosalë që ka gjithësej 8925 m²), gjatë hartimit janë marrë parasysh edhe përvojat dhe praktikat më të mira nga vendet e BE-së. Gjithashtu, janë shfrytëzuar materialet dhe dokumentet si në vijim:

- Plani Zhvillimor i Komunës së Ferizaj;
- Global solar Atlas,
- PW watts,
- PV-SOL – software,
- Certifikata e pronësisë,
- Hartat e rrezatimit diellor
- Photovoltaic geographical information system, etj

3.1 Zona e studimit

Raporti i Vlerësimit të ndikimit në Mjedis merr parasysh jo vetëm lokacionin ku është paraparë të ndërtohet projekti por edhe zonën përreth duke i shfrytëzuar edhe të dhënat nga dokumentet zhvillimore dhe studimet për problemet mjedisore në komunën e Ferizajt. Projekti është i paraparë të ndërtohet në territorin e Komunës së Ferizaj, në zonën kadastrale Sojevë në parcelën me nr. P-72217082 - 02057- 0 dhe në zonën kadastrale Mirosalë në parcelën me nr. P-72217058 – 02083 - 9.




Figura 2. Parcelat ne te cilat do te vendosen panelet solare

Topografia e këtyre vendeve është e valëzuar me lartësi që variron me lartësi nga 560-570 metër lartësi mbidetare. Këto toka nuk përdorën sepse janë të mbuluara me shkurre të vogla dhe bimësi e ulet është toke e pa punuar.

Në zonën kadastrale Mirosalë vendbanimi më i afërt me lokacionin e projektit është 360.0 m nga Panelet Solare.




Figura 3. Lokacioni me objekte për rreth në zonën kadastrale Mirosalë

Në zonën kadastrale Sojevë vendbanimi më i afërt me lokacionin e projektit është mbi 240 m nga Panelet Solare.




Figura 4. Lokacioni me objekte për rreth në zonën kadastrale Sojevë

Qyteti më i afërt me vendin e projektit është Ferizaj, i cili ndodhet rreth 8.3km.




Figura 5. Largësia me qytetin e Ferizajit

Për studimin e VNM-së, janë ndërmarrë përcaktimi i fushëveprimit për të identifikuar zonat e mundshme të ndikimit për projektin për të identifikuar ndërveprimet e mundshme midis

projektit dhe burimeve në zonën e ndikimit dhe ndikimet që mund të rezultojnë nga këto veprime dhe për t'i dhënë përparësi këtyre ndikimeve për sa i përket rëndësisë së tyre të mundshme. Kjo fazë synon të sigurojë që vlerësimi i ndikimit të fokusohet në çështjet që janë vendimmarrja më e rëndësishme dhe interesi i palëve të interesuara.

3.2 Te dhënat dhe analiza studimore

Për të siguruar një vlerësim me të mirë dhe gjithëpërfshirës, u realizuan vizita në terren ku u morën parasysh një sërë masash për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e mundshme. Këto përfshinin vendosjen e komponentëve të projektit në hartat e kushteve ekzistuese për të identifikuar zonat dhe çështjet me ndikim të mundshëm; konsultimi me ekspertë; përvojë nga projekte të ngjashme; dhe dokumente të publikuara që ofrojnë udhëzime për kryerja e analizave të ndikimit për aktivitetet e zhvillimit industrial. Rëndësia e ndikimit dhe kriteret e rëndësisë së ndikimit janë përdorur për të identifikuar ndikimet e rëndësishme në aspektin e rreziqeve mjedisore dhe sociale, shëndetit, sigurisë publike dhe ndotjes së mjedisit në të gjitha mediumet, dhe dëmtimit të aseteve/pronës.

4. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Impianti fotovoltaik është paraparë të ndërtohet në territorin administrativ të Komunës së Ferizajt, në parcelën me nr. P-72217082- 02057-0 zona kadastrale Sojevë dhe në parcelen me nr. P-72217058-02083-9 zona kadastrale Mirosalë.

Pozita gjeografike e shtrirjes së parcelave është shumë e përshtatshme për ndërtimin parqeve solare për prodhim të energjisë diellore për arsye se ka shtrirjen nga veriu në drejtim të jugut ku rrezet e diellit e kapin nga lindja e deri në perëndim pa ndonjë problem.




Figura 6 Shtrirja hapësinore e lokacionit të Impiantit Fotovoltaik 6.6 MW – Sojevë dhe Mirosalë

Në hartat e prezantuara më poshtë janë të dhënat për vendin se ku pritet të zhvillohet projekti, duke filluar nga paraqitja e koordinatave, largësia nga lumenjtë, largësia nga zonat e mbrojtura e të tjera të dhëna të nevojshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis për ndërtimin e Impiantit Fotovoltaik 6.0 MW – Sojevë dhe Mirosalë:




Figura 7 Plani i situacionit me ortofoto ne përpjesë të lexueshme me te gjitha te dhënat e nevojshme siç kërkohet në Ligjin për VNM




Figura 8 Largësia e zonës së projektit nga zonat e mbrojtura dhe Lumi me i afërt

Distanca nga zona e mbrojtur e bifurkacionit është 8.40 km, ndërsa nga zona e mbrojtur e Gadimes është 8.03 km ndërsa Lumi me i afërt është lumi i Sojevës i cili gjendet në distancë 143.74 m, Liqeni me i afërt është në distancë 2.91 km, Nënstacioni është 201 m, ndërsa përgjatë parcelave ku planifikohen të ndërtohen panelet solare kalojnë linjat me nivel të tensionit të lart 110 dhe 400 kv (fig 8).

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Ndotja e mjedisit në tërë territorin e Kosovës është një problem mjaft serioz dhe është prezent pothuajse kudo. Po ashtu edhe në komunën e Ferizajt kjo çështje është evidente. Ndotja më e madhe bëhet me lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj. Gjithashtu hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh. Për shkak të nevojave për djegie por edhe për ekonomi pyjet dëmtohen pa kriter nga fshatarët. Rrjeta e lumenjve (përroskave) është mjaft e përhapur dhe mbulon tërë territorin e komunës. Sasia e ujit në to është mjaft e vogël dhe e pamjaftueshme. Të gjithë lumenjtë burojnë në territorin e komunës së Ferizajt dhe sasia e ujit ndryshon gjatë stinëve të vitit. Në mbarim të vjeshtës, gjatë dimrit dhe në fillim të pranverës kur të reshurat janë të shpeshta dhe të mëdha pas shkrirjes së borës sasia e ujit rritet, duke rrezikuar me vërshime (përmytje), ndërsa gjatë muajve të verës në shumë raste lumenjtë thahen në tërësi.

Faktor tjetër që shkakton vërshimet është edhe faktori njeri gjatë veprimtarive të veta si:

- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike;
- Hedhja e mbeturinave në lumenj;
- Mbjellje e bimëve të larta dhe atyre të vet-rritura në afërsi të lumit;

Këtu do të përmendim Lumin Nerodime, i cili gjatë periudhave me reshje të mëdha, rrezikohen disa fshatra afër tij i cili disa here ka dale nga shtrati i tij.

Në mënyrë që të mënjanoen vërshimet nga ky lum, nevojitet që të ndërmerren masa parandaluese si:

- Rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit;
- Ndërtimi argjinaturave dhe
- Ndalimi i ndërhyrjeve në afërsi të lumenjve.

5.1 Flora dhe Fauna

Gjendja e florës dhe faunës nuk është e kënaqshme, shkaktarë të kësaj gjendje janë: gjuetia e paligjshme dhe pa kriter, përndjekja dhe kapja e kafshëve me qëllim tregtie, shqetësimi i vazhdueshëm nga ana e njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia dhe dëmtimi i pyjeve, shkatërrimi i habitateve natyrore, ndikimi i urbanizmit, transportit dhe turizmit, grumbullimi pa kriter i bimëve mjekuese dhe kërpudhave etj. Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë, siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit etj., shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës.

Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme. Nga kjo nuk janë kursyer as zonat e mbrojtura me vlera të veçanta të trashëgimisë natyrore si: Bifurkacioni i lumit Neredime, ndërtimet e shtëpive, ndërhyrjet (ngushtimet) në shtretërit e dy degëve të lumit, derdhja e ujërave të ndotura etj.

5.2 Klima

Të dhënat për kushtet klimatike janë marrë nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për periudhën 1949 – 2007 të cilat janë dhënë për rajonin e Ferizajt dhe të Shtimes. Komuna e Ferizajt karakterizohet me klimë kontinentale, si edhe pjesa më e madhe e Fushës së Kosovës. Lumi më i madh Nerodime përshkon tërë territorin e komunës.

5.3 Temperatura

Temperatura mesatare vjetore në Komuna e Ferizajt është 10 gradë celsius, gjersa 9gradë celsius në viset malore. Muajt më të nxehtë janë Korriku dhe Gushti më temperature mesatare 20,6 dhe 20,5 gradë celsius, ndërsa më i ftohti është janari më –1,4 gradë celsius. Maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është në Gusht 37,3 gradë celsius, ndërsa minimumi –26,0 gradë celsius . Sipas të dhënave të IHMK. Në vitin 1963 në Ferizaj është regjistruar temperatura maksimale ekstreme -34.0 gradë celsius.

Tabela 1 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën1949 – 2007

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	-1.2	0.9	5.7	9.9	14.6	17.9	19.9	19.8	16.0	10.5	5.3	0.9	10.0




Figura 9 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën1949 – 2007

5.4 Lagështia relative e ajrit

Ka vlerë mesatare vjetore 74,7% më muajin gusht më të thatë (63%) dhe me muajin më lagështi më të madhe janarin (86,1%). Sipas të dhënave të IHMK. Lagështia më e lartë mesatare sillet prej 85.0 % deri 87.0 %, në muajt Dhjetor dhe Janar, ndërsa ajo më e ultë në muajt Prill dhe Maj, e cila sillet prej 68.2 % deri 68.4 %. Kohë me vranësi më të lartë ka janari me 7.3/10, ndërsa vranësi më të ultë ka gushti me 3.8/10.

5.5 Vrantësimi dhe diellosja

Në këtë rajon vrantësimi mesatar vjetor është 57% gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 57,9 (15,9% nga viti), sipas të dhënave të IHMK. Insolimi mesatar vjetor në Ferizaj është 2 034 orë me diell. Muaji me më shumë orë me diell është gushti me 264.6 orë, ndërsa dhjetori karakterizohet me kohën më të shkurtër të insolimit, mesatarisht 63.8 orë.




Figura 10 Mesatarja vjetore e diellosjes viti 2018

5.6 Të reshurat

Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë. Sasitë mesatare vjetore sillen rreth 673,3 mm në Ferizaj, sipas të dhënave të IHMK. Muaji me më së shumti të reshura është maji, me 105.6 mm, ndërsa me më së paku gushti, me 42.2 mm. Mesatarisht toka e Ferizajt është 51.8 ditë e mbuluar me borë. Në janar ka më së shumti borë (17.0 ditë), ndërsa më së paku borë ka prilli (1.0 ditë).




Figura 11 Reshjet Mesatare Vjetore

5.7 Era

Frekuencën më të madhe vjetore në rajonin e Ferizajt e kanë erërat verilindore (NE) me 226 0/00, ndërsa më të voglën ato lindore (E) me gjithsejtë 36 0/00. Shpejtësia mesatare është më e madhja të era jugpërendimore (SË) 4,0m/sek, sipas të dhënave të IHMK.

5.8 Shtypja atmosferike

Sipas pozitës gjeografike të Ferizajt, ndryshimet e elementeve dhe dukurive atmosferike janë në konditat normale të ndryshimit të shtypjes atmosferike për këtë rajon.

5.9 Cilësia e ajërit

Plani Zhvillimor Komunal I Komunes se Ferizajt adreson problemet ajrit në aspektin e ndotjes dhe cilësisë së tij. Prania e komunikacionit hekurudhor e autostradës “Arbën Xhaferi” dhe magjistraleve Prishtinë – Shkup, Gjilan – Ferizaj dhe Ferizaj - Shtime në këtë komunë është një element që tregon se ka shkarkim të konsiderueshëm të gasrave në atmosferë, si dhe lirim të zhurmave të ndryshme që vijnë nga komunikacioni. Ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2024 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli cilësisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të biçikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. Grimcat e imëta PM₁₀ (të ngurta, të lëngshme ose gaz) mund të depërtojnë në mushkëri duke shkaktuar efekte të mëdha shëndetësore të tilla si sulmet në zemër, kanceri në mushkëri, bronkitin kronik dhe ndikim më seriozi katek të moshuarit, fëmijët dhe diabetikët. Efekte të vogla shëndetësore përfshijnë. Këto efekte shëndetësore ndikojnë në cilësinë e jetesës çdokujt dhe ndërhyjnë në mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të banorëve

të komunës së Ferizajt. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së semundshmerise me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe kostos ekonomike 210 që sjell ndotja e ajrit për Komunën e Ferizajt.

Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave kolektive gjatë sezonit të dimrit, e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lëndëve tjera djegëse, cilësia e të cilave nuk është e kontrolluar. Institucioni për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës (IHMK). Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Nr. 08 / L-025; dhe LIGJI NR. 06/L-035 PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEOROLOGJIKE, IHMK është i obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës. Në territorin e komunës së Ferizajt nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit, andaj në një të ardhme të afërt do duhet të vendosen instrumente monitoruese në disa pika me te frekuentuara nga makinat. Mungesa e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit si pasqyrim i plotë i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit e pamundëson edhe marrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parandalimin e ndotjes.

5.10 Djellosja

Lokacioni ku është paraparë vendosja e paneleve solare (diellore) është një zonë me potencial fotovoltaik të mirë e cila ka shtrirje te mire siç shihet edhe më poshtë në hartën e përgatitur nga studimet e bëra për territorin e Ferizajt, kjo është edhe një prej arsyeve kryesore që investitori është fokusuar për ndërtimin e parkut të energjisë solare në këtë lokacion.




Figura 12 Harta e fuqisë potenciale të rrezatimit fotovoltaik në territorin e Kosovës

5.11 Karakteristikat Hidrografike

Rajoni përreth Ferizajt merret si mbarimi i Rrafshit të Kosovës dhe lidhja e saj hapësinore me Anamoravën. Ky rajon kufizohet me Malin e Sharrit në jugperëndim, me Karadakun dhe Anamoravën në lindje, dhe me Malet e Drenicës në veriperëndim. Nëpër territorin e Komunës rrjedhin lumenj dhe përrenj të shumtë. Lumi kryesor është ai i Nerodimes, i cili kalon edhe

nëpër qytetin e Ferizajt. Ky lum është i mbuluar brenda qytetit. Hidrografinë e këtij lumi e përbëjnë 13 përrenj. Lartësia mbidetare e lumit në Ferizaj është 580m. Komuna e Ferizajt ka ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ujërat Sipërfaqësore Ujërat sipërfaqësore rrjedhin përgjatë lumit Nerodime, i cila është degë e rëndësishme e Lumit Lepenc. Lumi Nerodime përbëhet prej dy lumenjve, Lumi i Madh dhe Lumi i Vogël, që burojnë në rrëzën jugore të malit të Nerodimës, në lartësi mbidetare prej 1200m është 0.9m³/sec. Gjatësia e rrjedhës së lumit Nerodime është 29 km, sipërfaqja e pellgut 255km², ndërsa sasia mesatare. Lumi Nerodime është rrjedhë e dobët për shkak të bigëzimit – bifurkimit, fenomen i rëndësishëm gjeografik, i njohur edhe në botën e jashtme. Bifurkacioni gjendet 1 km në veri-përëndim të Ferizajt, mbi dhe nën vendin e quajtur te Mulliri i Nikës. Si fenomen natyror është i njohur që nga viti 1321. Ujërat tjerë sipërfaqësor në territorin e Komunës së Ferizajt, janë në shfrytëzim për ujitjen e tokës, lumi i Pleshinës dhe i Gremës, që bashkohen me lumin Nerodime të fshati Gurëz (dega e lumit Nerodime që derdhet në lumin Lepenc). Sipas disa matjeve që janë bërë në maj të vitit 2007 nga një Institut i Londrës, kapaciteti prurës i lumit Nerodime është 848 l/sec. Mirëpo ky kapacitet në shfrytëzim, në korrik-gusht bie në 30 l/sec.

Ujërat nëntokësore Rezervat e ujërave nëntokësore të hulumtuara janë përgjatë degës së dytë në veri-lindje të Nerodimës. Shpuarjet që janë bërë më herët në oborrin e fabrikës së gypave, kanë prurje prej 70 l/s. Disa shpuarje që janë bërë në disa fshatra, së fundi, nga Komuna, nga Elektrovati dhe BP, rezultojnë se sasia e ujërave nëntokësore për shpuarje, sillet 68 prej 7- 15 l/s. Shkalla e ndotjes së ujërave në lumenj dhe përroska është mjaft e lartë, varësisht nga koncentrimi i popullatës, afër lumenjve kemi shkallë të ndryshme të ndotjes.




Figura 13 Rrjeti Hidrografik i Komunës së Ferizajt

5.12 Gjeologjia dhe Pedologjia

Morfologjinë e relievit të hapësirës së Ferizajt si dhe Kosovës e kanë përcaktuar fuqitë e brendshme dhe të jashtme gjatë një kohe të gjatë gjeologjike. Krijimi i hapësirës së Ferizajt nuk mund të shikohet si hapësirë e ndarë nga ai i Kosovës. Territori i Kosovës i takon sistemit orogjenik të Tetisit i rrudhosur në depozitimet e formuara gjatë mesozoikut dhe pjesërisht kenozoikut. Ndërtimi gjeologjik i Ferizajt përbëhet kryesisht prej: Serpentinite; Ranor, marlstone; Ranor, lymore, marlstone, rere me olistoliths (flishit rërë); Gur ranor, mudstone, siltstone; Ranor, marlstone, rere; Ranor, konglomerat, mudstone, lymore; Tarraca lumore; Rife gëlqeror, gur gëlqeror rudist; Rife gëlqeror; Rreshpe kuarc kuarcite; kuarcite metakuarcsandstone, konglomerat; Proluvium; Paraschist (phyllite, sericite schist, quartz schist, metasandstone); Rreshpe orto (epidote, aktinolite dhe rreshpe klorite); Orto rreshpe (epidote rreshpe, rreshpe chlorite, intercalations pjesërisht diabaz); Orto rreshpe (epidote rreshpe, actinolite rreshpe chlorite, intercalations pjesërisht diabaz); Quartzite mikë, metasandstone, metamudstone; Metaquartz poroze; Metadiabaz, metaspilit; Përzierje me olistoliths; Mermer, gëlqeror në rikristalizim; Mermeri kuarcite, rreshpe sericite; Mermer, cherty rreshpe gelqerore, partly black recrystallised limestone; Mermer, rreshpe gëlqeror; Mermer; Limestone, marlstone, siltstone, sandstone (calcareous flysch); Guri gëlqeror me qert;

Sediment lumor dhe liqenor; Diabaz, spilite, basalt; Konglomeratit breccia, ranore, gur gëlqeror; Argjilë, rërë, zhavorr, mergelore, pjesërisht linjtit; Breccias and blocks; Biotite, muskovite, reshpe; Amfibolite, amfibole, reshpe; Alluvium. Përbërja gjeologjike e dheut në Komunën e Ferizajt ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë. Përbërja gjeologjike është si vijon:

1. Tokë e kuqërremtë-kafe e lesivuar mbi sediment të kuqërremtë 22 %
2. Tokë e kuqërremtë – kafe ranore deltinore 20 %
3. Smonicë e pa karbonizuar 10 %
4. Smonicë në proces të kafenizimit 7 %
5. Smonicë e kafenizuar..... 5 %
6. Smonicë e lesivuar me pseudoglej..... 8 %
7. Tokë livadh – argjilore 5 %
8. Tokë podzollake – pseudoglej 10 %
9. Tokë e kafenjtit e cektë dhe mesatarisht e thellë 7 %
10. Tokë aluviale ranore, deltinore dhe e kafenizuar 5 %
11. Tokë e aglejuar mineralo – moçalike 1 %

Në të dy anët e lumit Nerodime mbi rrafshinat aluviale janë të përhapura sendimentet liqenore të pliocenit. Ato janë të përfaqësuar me argjila ranore dhe mergele. Si një rezultat i një ndërtimi gjeologjik të llojllojshëm kemi një larmi të mineraleve të metaleve.




Figura 14 Harta gjeologjike e Komunës së Ferizajt




Figura 15 Harta Pedologjike e Komunës së Ferizajt

5.13 Lartësia Mbidetare

Territori i Komunës së Ferizajt gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600 m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore. Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunës. Komuna paraqitet në ndarje të tërthortë në Rrafshin e Kosovës e rrafshlartat e Jezercit, Neredimes në përendim dhe rrafshlarta e fshatrave Zllatar, Rahavicë etj. në juglindje. Lugina e Moravës. Kjo zonë ka lidhje më të afërt hapësinore me Lipjanin dhe me Kaçanikun. Qyteti i Ferizaj shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe luginës së Moravës. Majat më të larta në lindje dhe përendim së bashku arrijnë mbi 1000m. Pjesët më të larta janë kryesisht të mbuluara me pyje, një zonë e madhe pyjore e mbrojtur shtrihet në male në veripërendim. Pas luftës 1990 është bërë një vend i rëndësishëm për rekreacion. Nga të dhënat e përgjithshme të Komunës të relievit të territorit të Komunës së Ferizajt sipas të cilave:

- pjesa më e madhe e sipërfaqeve janë rrafshina me 44.53 %;
- nga ana jugpërendimore 10.98 %;
- të lindjes 4.03 %;
- pjesa veriore si më negative është kryesisht në terrenet e larta rreth 5.78 %;
- verilindore 7.96%; dhe
- veripërendimore 6.71%

Tabela 2 Pjerrtësia e terrenit sipas përqindjes dhe sipërfaqes në hektarë

Pjerrtësia e terrenit (%)	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja (ha)
0 - 3.817 %	11,824	34.93%
3.817 - 8.80%	5,099	15.06%
8.80– 14.09	4,631	13.68%
14.09 – 19.38	3,794	11.21%
19.38 – 24.96	3,199	9.45%
24.96 – 30.83	2,394	7.07%
30.83 – 37.29	1,611	4.76%
37.29 – 45.80	941	2.78%
45.80 – 74.88	326	0.96%
Totali	33,854	

5.14 Pylltaria

Në kudër të Librit të Gjellbër të Kosovës- “ Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm Bujqësor dhe Rural në Kosovë”, e hartuar gjatë viteve 2001-2002 dhe e miratuar në muajin maj 2003

është edhe zhvillimi i Sektorit të Pylltarisë në Kosovë. Sektori i pylltarisë, ngjashëm me sektorët tjerë për kohë të gjatë është ballafaquar me probleme dhe sfida të shumta, shumë prej të cilave nuk janë zgjidhur deri në këtë kohë. Pyjet dhe resurset pyjore me pjesëmarrjen e tyre afro 42% në sipërfaqen e përgjithshme të Kosovës, rendësin e tyre ekologjike, sociale, shëndetësore dhe ekonomike kanë rendësi dhe ndikim të madh në planifikimin hapësinor. Kosovë ka 430000 ha (40.25 % e territorit të Kosovës) është e mbuluar me tokë pyjore dhe gjysmë - natyrore, nga të cilat komuna e Ferizajt posedon 13860.50 ha apo 3.22 % të mbulushmërisë së përgjithshme të territorit të Kosovës. Pyjet dhe resurset pyjore me pjesëmarrjen e tyre afro 39.6% në sipërfaqen e përgjithshme të komunës së Ferizajt, rendësin e tyre ekologjike, sociale, shëndetësore dhe ekonomike kanë rendësi dhe ndikim të madh në planifikimin hapësinor. Struktura pyjore ekzistuese, sasia e sipërfaqeve të zhveshura, nevoja e shpalljes së zonave të mbrojtura, nevoja e ruajtjes së tokave pyjore, zhvillimi i infrastrukturës pyjore, ndërrimi i destinimit të tokave pyjore etj. imponojnë qasje serioze të trajtimit të këtij sektori si komponent e rëndësishme e planifikimit hapësinor.

Lloji pyjor Sipërfaqe (ha)

- Pyjet e larta (trungishtë) 4145.10
- Pyjet e uleta (cungishte) 2318.50
- Pyjet e degraduara 2585.70
- Shkurre/kaçuba 685.20 Totali 9734.50

Sipërfaqja e tërësishme e mbuluar me pyje në komunën e Ferizajt është afërsisht rreth 13860.50 ha, apo 39.6% të sipërfaqes së tërësishme të komunës së Ferizajt. Prej tyre rreth 4126 ha është në pronësi private, ndërsa 9734.50 ha janë pronë publike - shtetërore. Klasifikimi në bazë të kategorive të pronësisë dhe llojeve kryesore të pyjeve është paraqitur në tabelën më poshtë:

- Pyjet e ulëta (cungishte), vlerësohen me se 24 % të zonës pyjore, ndërsa rreth 43% vlerësohen si pyje të larta (trungishte). Ndërsa të tjerat janë klasifikuar si të degraduara dhe shkurre. Përveç këtyre zonave, ekzistojnë edhe 50 ha të tjerë, të klasifikuar si tokë pyjore.
- Masa drunore e përgjithshme është vlerësuar rreth 1031778 m³.
- Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve dhe tokave pyjore është 13860.50ha, prej të cilave vetëm pyje janë rreth 9049.30 ha.

- Vëllimi i përgjithshëm drunor në është rreth 1031,778 m³ . Vëllimi mesatar vjetor për hektar është 114m³ /ha. Sipas të gjitha analizave të bëra shtimi vjetor për pyjet e larta është 3 - 5 m³ /ha, ndërsa për pyjet e ulëta nga 1.5 - 3 m³ /ha.

Llojet (speciet) kryesore drunore - Për nga shtrirja hapësinore llojet kryesore drunore në komunën e Ferizajt janë dushku dhe ahu nga gjetherënësit ndërsa pisha, bredhi, hormaoqi larqi, etj nga gjethembajtësit, llojet tjera drunore janë: frashëri, shkoza, lajthia, verriri, plepi, panjat, gështenja. Duke ditur rëndësin e pyjeve në mjedis është shumë e rëndësishme dhe parimore që pyjet të zhvillohen dhe menaxhohen me mençuri dhe në përputhje me parimet e menaxhimit qëndrueshëm të pyjeve. Mjedisi natyror në Kosovë është dëmtuar për shkak të prerjes së tepërt të pyjeve, prerjes ilegale dhe efekteve të përhapjes së pakontrolluar urbane. 40% e pyjeve publike dhe 29% e pyjeve private i janë nënshtruar aktiviteteve të pakontrolluara dhe ilegale të prerjes së drunjve, kjo dukuri ka qenë e pranishme edhe në komunën e tonë. Gjendja është shumë kritike në pyjet halore, ku është vënë në rrezik e tërë ekzistenca e zonave të mëdha pyjore nëse nuk ndërmerren veprime të menjëhershme dhe të fuqishme. Rezultatet e regjistrimit konfirmojnë gjithashtu se zabelet, sidomos në tokat pyjore publike, i janë ekspozuar prerjes serioze. Regjistrimet e pyjeve tregojnë nevojën urgjente për intervenim në menaxhim të pyjeve shumë të reja dhe të mesme, duke filluar nga pastrimi deri te rrallisja për tregti. Prandaj, është me rëndësi të veçantë në qoftë se pyjet do të menaxhohen në potencialin e tyre më të lartë ekonomik dhe mjedisor. Duke pasur parasysh nevojat shoqërore - ekonomike, mjedisore, kulturore dhe shpirtërore, synimi kryesorë i kriterëve dhe treguesve është të nxiten me kohë praktikatat e menaxhimit të përmirësuar të pyjeve dhe zhvillohet më tutje prona më e shëndoshë dhe më produktive, duke pasur parasysh nevojat shoqërore-ekonomike, mjedisore, kulturore dhe shpirtërore.

5.15 Popullsia

Komuna e Ferizajt ka 344.64 km² , ka gjithsejtë 44 fshatra, në të cilat jetojnë gjysma e popullatës së kësaj komune. fshatrat më mëdha janë Dardania, Gremja, Komogllava, në të cilat jetojnë mbi 6.000 banorë. Komuna e Ferizajt sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ka 108 610 banorë.¹² Gjersa sipas vjetarit të fundit 2016, në Komunë aktualisht jetojnë 101,174 banorë, prej tyre gjysma jetojnë në qytet dhe gjysma në fshatra.¹³ Nga komunitetet tjera jetojnë rreth 3700 banorë, kryesisht Ashkalinjë, Romë, Goranë, Mysliman, Serbë, në të cilat përbëjnë rreth 2,06 % të popullatës.

Tabela 3 Karakteristikat e vendbanimeve të Komunës

	Fshatra	Lagje urbane
Numri i vendbanimeve	45	8
Sipërfaqja (ha)	2300.92	1837.1
Numri i banorëve	65,982	42,628
Dendësia (ba/ha)	28.68	23.20

5.16 Ndikimet mjedisore te lidhura me popullatën dhe shëndetin

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndërtimi-rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe menaxhimi i mbetjeve.
- Rehabilitimi i zonave me ndotje të lart dhe atyre që janë potencial për ndotje tëkomponentëve mjedisore;
- Ruajtja e burimeve të ujit të pijshëm nga ndotja;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet medensitet të lartë;
- Promovimi i mobilitetit, e ecjes dhe çiklizmit;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetine popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore në shëndetin e njeriut;

6. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE PROCESIT TEKNOLOGJIK

Pv modulet që do të përdoren në centralin solar janë të prodhuara nga prodhuesit Kinez. Këto dimensione të Pv Modulit janë të përshtatshëm për struktura të cilat përdoren në natyrë dhe janë të rezistueshëm ndaj faktorëve të jashtëm.

Moduli IBEX66M-EiGER 665-670 posedon të gjitha certifikatat EC dhe ka garancionin e reciklimit. Rendet e paneleve nuk do të jenë të gjithë njësoj sepse parcela nuk ka forme të rregullt.



Figura 16 Impianti Fotovoltaik paraqitja skematike

Numri i paneleve do të jete 8,956 copë



Figura 17 Pv Modulet e planifikuara për vendosje në parkun solar 6.0 MW

Materialet dhe pajisjet fotovoltaike (PV) konvertojnë dritën e diellit në energji elektrike. Një pajisje e vetme PV njihet si një qelizë. Një qelizë PV individuale zakonisht është e vogël, zakonisht prodhon rreth 1 ose 2 vat energji. Për të rritur prodhimin e energjisë të qelizave PV, ato janë të lidhura së bashku në zinxhirë për të formuar njësi më të mëdha të njohura si module ose panele. Modulet mund të

përdoren individualisht, ose disa mund të lidhen për të formuar vargjet (vargjet). Një ose më shumë vargje pastaj janë të lidhura me konverter DC/AC pajisje elektrike e cila është e lidhur me rrjetin elektrik dhe për të krijuar një pjesë të një sistemi të plotë PV.

IBEX66M-EiGER 665-670

MONOCRYSTALLINE SOLAR MODULE

ELECTRICAL DATA AT STC		
Rated power P _{mpp} [Wp]	665	670
P _{mpp} range to	0/+5W	0/+5W
Rated current I _{mpp} [A]	17.50A	17.54A
Rated voltage V _{mpp} [V]	38.00V	38.20V
Short-circuit current I _{sc} [A]	18.58A	18.62A
Open-circuit voltage U _{oc} [V]	45.80V	46.00V
Efficiency at STC up to	21.40%	21.60%
Application Class	Class A	Class A

Specification as per STC (Standard test conditions): Irradiance 1000 W/m² | module temperature 25°C | Air Mass = 1.5

ELECTRICAL DATA AT NOCT		
Power at P _{mpp} [Wp]	504.00	508.00
Rated current I _{mpp} [A]	14.24	14.28
Rated voltage V _{mpp} [V]	35.40	35.60
Short-circuit I _{sc} [A]	14.98	15.02
Open-circuit voltage U _{oc} [V]	43.00	43.20

NOCT (nominal operating cell temperature): Irradiance 800 W/m² | Wind speed 1m/sec | Ambient temperature | 20°C cell operating temperature 45 +/-2°C | Air Mass = 1.5

LIMITING VALUES	
Max. system voltage [V]	1500V DC (IEC)
Max. return current [I]	30A
Operating Temperature	- 40 to +85°C
Max.tested pressure load [Pa]2	5400
Max. tested tensile load [Pa]2	3800

TEMPERATURE COEFFICIENT		
I _{sc}	V _{oc}	P _{max}
0.04% /°C	-0.25% /°C	-0.34% /°C

SPECIFICATIONS	
Number of cells	132 (12 x 11) 210x105 mm
Dimensions	2384x1303x35 mm
Weight	33.9 kg
Front-side glass	3.2 mm tempered Low Iron Glass
Frame	Stable, anodised aluminium frame, black
Junction box	Split Junction Box (IP68)
Cable	4 mm ² , +350mm,-350mm Cust.Length
Diodes	3 Diodes
Plug-in connection	MC4 Compatible
Hail test (max. hailstrom)	Ø45mm 23 m/s 83 km/h

PACKING CONFIGURATION			
Container	40 HQ	Pieces Per Pallet	31
Pallets Per container	18	Pieces per Container	558

The specifications and average values can vary slightly. Relevant is the corresponding data of the individual measurement. Specifications are subject to change without notice. Measurement tolerance depending on equipment: rated power +/- 3%, other values +/- 10%. All information given in this data sheet corresponds to DIN EN 50381. A potential light-induced degradation of the power after commissioning is not considered here. Further information in the installation manual. 1 The specific warranty conditions are given under www.swissenergy-solar.ch | 2 Horizontal mounted | 3 Tolerance L/W = +/- 3 mm, H +/-2mm, the dimensions given in the order confirmation will be decisive | 4 Location and dimensions of holes on request.

BACK VIEW

WARRANTY

20 YEARS

PRODUCT WARRANTY

30 YEARS

POWER WARRANTY

6.1 Parimi i punës së qelizave fotovoltaike

Modulet diellore bënë shndërrimi i energjisë diellore në energji elektrike do të bëhet në një pajisje gjysmëpërçues që quhet celulë diellore. Celula diellore është një njësi dhe mund të jep vetëm një sasi të caktuar të energjisë elektrike. Në mënyrë që të përdorim energjinë elektrike diellore për pajisjet praktike, të cilat kërkojnë një tension të caktuar për funksionimin e tyre, duhet të lidhen së bashku një numër i celulave diellore për të formuar një panel diellor, që gjithashtu quhet edhe një modul PV. E përshkruar thjesht, efekti PV është si më poshtë: drita, e cila është energji e pastër, hyn në një qelizë PV dhe i jep energji të mjaftueshme disa elektroneve (grimcave atomike të ngarkuara negativisht) për t'i liruar ato. Një pengesë e ndërtuar në potencial në qelizë vepron në këto elektrone për të prodhuar një tension (të ashtuquajturit fotovoltazh), i cili mund të përdoret për të drejtuar një rrymë përmes një qarku.




Figura 18. Parimi i Punës së qelizave ne Fotovoltaike

Qeliza PV është e përbërë nga materiali gjysmëpërçues, i cili kombinon disa tipare të metaleve dhe disa karakteristika të izolatorëve. Kjo e bën atë në mënyrë unike të aftë për të konvertuar dritën në energji elektrike. Kur drita absorbohet nga një gjysmëpërçues, fotonët e dritës mund të transferojnë energjinë e tyre tek elektronet, duke lejuar që elektronet të rrjedhin përmes materialit si rrymë elektrike.

Për prodhimin në shkallë të gjerë të energjisë elektrike diellore panelet diellore janë të lidhura së bashku në një grup të paneleve diellore. Modulet diellore janë vetëm një pjesë e një sistemi PV diellore të plotë. Modulet diellore janë zemra e sistemit dhe zakonisht janë quajtur si gjeneratorë të energjisë. Këto gjithashtu, nevojitet të kenë edhe strukturën për montim në të cilat module PV janë të fiksuara dhe të drejtuara në drejtim të diellit. Për sistemet PV të cilët kanë për të vepruar gjatë natës ose gjatë periudhës së motit të keq nevojitet që energjia të ruhet, atëherë për ruajtjen e energjisë elektrike janë të nevojshme bateritë. Prodhimi i një moduli PV varet nga intensiteti i rrezeve të diellit dhe temperatura e celulave. Prandaj, nevojiten edhe komponentet që të mundësojnë që rryma e vazhduar e gjeneruar të dorëzohet në bateri, rrjet dhe/ose ngarkesës e të cilat mundësojnë një funksionimin normal të sistemit të PV. Këto komponente janë të njohura si rregullatorë të mbushjes. Pajisjeve elektrike për punën e tyre ju nevojitet rryma alternative dhe për këtë përdoren inverterët DC/AC të cilët janë implementuar në sistemet PV. Në projektin e propozuar do të instalohen gjithsej 18,720 module FV, ku secili gjeneron deri në 320 W.

6.2 Invertorët

Funksionet kryesore të inverterit janë: transformimi i energjisë elektrike të vazhduar në energji elektrike alternative në dalje të tij, si dhe rregullimin e vlerës efektive të tensionit në dalje. Karakteristikat më të rëndësishme të një inverteri për aplikime në sistemet PV janë besueshmëria e tij dhe karakteristika e efijencës. Ata janë të dizajnuara ashtu që sistemi PV të operoi në vazhdimësi pranë pikës së tij maksimale të energjisë. Shumë module në vargje seri dhe vargje paralele janë të lidhura me inverterët. Projekti do të kërkojë gjithsej 60 inverterë.

Dalja nga invertaret kërkon një rritje të tensionit për të arritur nivelin e tensionit të rrjetit AC. Transformatori rritës i tensionit merr tensionin e daljes nga inverterët (1000 V) dhe e rrit deri në 10(20) kV, i cili me pas bartet me anë të kablllove/linjës deri tek nënstacioni më i afërt.

Sistemet PV të lidhura në rrjet janë shumë të përhapura. Ato janë të lidhura në rrjet nëpërmjet të inverterit, dhe nuk kërkojnë bateri për shkak se rrjeti mund të pranojë tërë energjinë elektrike që një gjenerator PV mund të ofrojë. Nga ana tjetër ato mund të përdoren edhe si gjenerues të energjisë. Një sistem PV i lidhur në rrjet është paraqitur në mënyrë skematike në figurë.




Figura 19. Një sistem PV i lidhur në rrjet

Për këtë Park të Energjisë Diellore do të përdoren invertoret të cilat kanë garancione 20-30 vite dhe janë të dëshmuar në tregun Evropian.

Invertorët janë të modelit SWISS SOLAR tipi IBEX66M-EiGER 665-670. Ky lloj modeli i invertoreve është i prodhuar për gjenerimin e kapaciteteve të mëdha të prodhimit të energjisë Diellore dhe se ka avantazhin e vet për monitorim dhe mirëmbajtje.

6.3 Intensiteti i rrezatimit diellor

Rrezatimi diellor që arrin majën e atmosferës në një kënd pingul me rreze i njohur si konstante diellore, ka një vlerë mesatare prej 1372.3 kWh/m^2 , e cila ndryshon disi në varësi të pozicionit të Tokës në orbitën e saj eliptike.



Figura 20 Rrezatimi diellor i lokacionit të Hulumtuar

Rrezatimi diellor i pranuar në nivelin e tokës, i njohur si rrezatimi global, është shuma e tre komponentëve. E para, me emrin rreze ose rrezatim të drejtpërdrejtë, është fraksioni i rrezatimit diellor që arrin tokën pa u zbehur nga atmosfera dhe mund të modelohet si që vjen direkt nga disku diellor.

Pjesa e dytë ose difuzioni është rrezatimi diellor që arrin tokën pas reflektimit ose shpërndarjes nga atmosfera dhe konsiderohet të arrijë nga tërë kupola e qiellit. Komponenti i tretë, që nuk konsiderohet gjithmonë, është rrezatimi i reflektuar nga sipërfaqja tokësore ose pengesat aty pranë. Komponenti i rrezeve është i disponueshëm vetëm kur disku diellor nuk bllokohet nga retë, ndërkohë që përbërësi i shpërndarë është gjithmonë i disponueshëm, duke qenë i vetmi rrezatim i disponueshëm sa herë që retë bllokojnë diskun diellor.




Figura 21. Këndi i rrezeve të diellit dhe këndi i Azimutit dhe zenitit




Figura 22. Azimuti Solar per Lokacionin e Huluntuar

Modulet dhe panelet PV diellore punojnë më mirë kur sipërfaqja e tyre thithëse është pingul me rrezet hyrëse të diellit. Pozicioni i diellit në qiell mund të përpilohet duke përdorur dy kënde, azimuth dhe zenith dhe këndi i orientimit të panelit diellor mbështetet në këto dy vlera.

Azimuti - Ky është këndi busull i diellit, ndërsa lëvizë gjatë qiellit nga Lindja në Perëndim gjatë gjithë ditës. Në përgjithësi, azimuth llogaritet si një kënd nga jugu i vërtetë. Në mesditë rezatimi solar është definuar si këndi azimuth i gradave zero, pra $\text{Azimuth} = 0^\circ$, dielli do të jetë drejtpërdrejt në jug në hemisferën veriore dhe drejtpërdrejt në veri në hemisferën jugore.

Këndet diellore të azimuthit në lindje nga jugu janë negative në natyrë, me në lindje që ka një kënd të azimuthit prej -90° . Këndet diellore të azimuthit në perëndim të jugut janë pozitive në natyrë, me perëndim të mirë që ka një kënd të azimuthit prej $+90^\circ$. Në përgjithësi, megjithatë, këndi azimuthit i kërkuar për orientimin e duhur të panelit diellor ndryshon me gjerësinë dhe kohën e vitit.

Zeniti - Ky është këndi i diellit duke kërkuar lart nga niveli i tokës ose horizonti. Këndi zenitit i diellit ndryshon gjatë gjithë ditës në formën e një harku me diellin duke arritur lartësinë maksimale (e quajtur gjithashtu lartësi diellore) rreth mesditës. Lartësitë e diellit përkufizohen si 0° në lindjen dhe në perëndim të diellit, dhe 90° në mesditë kur dielli është direkt lart.

6.4 Mirëmbajtja

Panelet Fotovoltaike kanë një jetëgjatësi prej 25 (e garantuar) – 30 vite me mirëmbajtje të rregullt. Invertorët nga 10 deri në 20 vite garancion të prodhimit. Kabllot, konektorët dhe pajisjet tjera të telekomunikimit kanë garancion mbi 25 vite. Krejt kjo ndikon në një kosto shumë të ulët të mirëmbajtjes. Nga këto del se lokacioni i përzgjedhur është i përshtatshëm për instalimin e centralit solar dhe se nuk shihet ndonjë pengesë teknike apo funksionale.



Figura 23 Mirëmbajtja e paneleve model se si duhet te jete

6.5 Struktura e Vendosijes se Paneleve Fotovoltaike

